

# KRIMI, SIGURIA DHE TË DREJTAT E VIKTIMAVE

## PËRMBLEDHJE

### ANKETË PËR TË DREJTAT THEMELORE

**3**

Përvojat me dhunën

**9**

Përvojat me ngacmimin

**12**

Përvojat me disa lloje krimesh kundër pronës  
dhe me mashtrimin

**15**

Kallëzimi i përvojave me krimin pranë policisë  
dhe autoriteteve të tjera

**18**

Dëshmimi i krimit dhe reagimi

**20**

Shqetësimi rreth viktimizimit potencial  
dhe shmangia e rrezikut

© Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2021.

Riprodhimi autorizohet me kusht që të citohet burimi.

Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive apo materialeve të tjera që nuk kryhet sipas të drejtave të autorit të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, duhet të kërkohet leje drejtpërdrejt nga zotëruesit e të drejtave të autorit.

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore apo personat që veprojnë në emër të saj nuk mbajnë përgjegjësi për mënyrat e përdorimit të informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2021.

|       |                        |                    |                   |
|-------|------------------------|--------------------|-------------------|
| Print | ISBN 978-92-9461-199-4 | doi:10.2811/793078 | TK-06-20-041-SQ-C |
| PDF   | ISBN 978-92-9461-196-3 | doi:10.2811/564794 | TK-06-20-041-SQ-N |

Burimi ku janë marrë fotografitë:

Ballina: © AlexLinch/iStock

Faqe 5: © jayzynism/Adobe Stock

Faqe 8: © JackF/Adobe Stock

Faqe 11: © Daisy-Daisy/iStock

Faqe 14: © terovesalainen/Adobe Stock

Faqe 17: © kumikomini/iStock

Faqe 21: © krsmanovic/Adobe Stock

Krimi, veçanërisht krimi i dhunshëm, cenon të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore të viktimës. Këtu përfshihet edhe e drejta e jetës dhe respektimit të dinjitetit njerëzor në kontekstin e krimit të dhunshëm, si dhe e drejta e aksesit në drejtësi në rastin e kallëzimit të një krimi dhe e drejta për mosdiskriminim gjatë trajtimit në cilësinë e viktimës. Krimi cenon gjithashtu edhe të drejta të tjera, si p.sh. ato që lidhen me pronësinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Kjo përmbledhje prezanton idetë kyçe të nxjerra nga raporti i dytë kryesor i Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), i bazuar në Anketën e tij për të Drejtat Themelore. Raporti përqendrohet te përvojat e personave në cilësinë e viktimave të krimeve të caktuara. Në mënyrë të veçantë, raporti trajton:

- dhunën,
- ngacmimin, si në internet ashtu dhe jashtë tij,
- krimet ndaj pronës – vjedhjet me thyerje, keqpërdorimin e llogarisë bankare në internet ose të kartave bankare të personave të tjerë dhe mashtrimin ndaj konsumatorit.

Raporti shqyrton gjithashtu shpeshhtësinë e kallëzimit të këtyre krimeve në polici dhe jep detaje shtesë për ngacmimin dhe dhunën, për shembull për autorët e krimit dhe vendngjarjen e incidenteve. Përzgjedhja e këtyre krimeve pasqyron krimet ndaj personit dhe ndaj pronës, krimet "tradicionale" si vjedhjet me thyerje, si dhe krimet që mund të ndodhin në internet dhe jashtë tij.

Përveç kësaj, analiza merr në shqyrtim edhe nivelin e shqetësimit të njerëzve rreth viktimizimit potencial dhe nëse ata kanë ndryshuar sjelljen në formë reagimi ndaj rrezikut të perceptuar të sulmit ose ngacmimit, për të shmangur situatat ku mund të ndodhin këto lloj incidentesh.

Raporti hulumton edhe shkallën e gatishmërisë së njerëzve për të ndërhyrë, për të kallëzuar në polici ose, nëse u kërkohet, të dëshmojnë në gjykatë në tre skenarë të mundshëm: dhunë fizike midis partnerëve, dhunë fizike e ushtruar mbi një fëmijë dhe krim kundër mjedisit.

Rezultatet e paraqitura ofrojnë të dhënat e para të anketave mbi krimin në nivel BE-je për përvojat e viktimizimit nga krimi të popullatës së gjerë. Këto rezultate mund të përdoren për të orientuar politikat dhe legjislacionin kombëtar dhe ato të BE-së për viktimat e krimit.

## Anketa për të Drejtat Themelore: faktet kryesore

Anketa për të Drejtat Themelore mbledhi të dhëna në 29 shtete: në 27 shtetet anëtare të BE-së, në Mbretërinë e Bashkuar (shtet anëtar i BE-së në momentin e realizimit të anketës) dhe në Maqedoninë e Veriut (i vetmi vend jo anëtar i BE-së me status vëzhguesi në FRA, në momentin kur u hartua anketa). Në secilin shtet morën pjesë një numër të anketuarish, si kampion përfaqësues, që varionin nga rreth 1000 persona në pjesën më

të madhe të shteteve deri në rreth 3000 persona në Francë dhe Gjermani. Intervistat e anketës që u zhvilluan në periudhën janar-tetor 2019, prodhuan një kampion prej 34 948 të anketuarish.

Rezultatet janë përfaqësuese në nivelin e Bashkimit Evropian dhe për secilin shtet, për personat 16 vjeç e lart dhe zakonisht me banim në vendin ku janë intervistuar për anketën.


## Shkalla e përgjithshme e viktimizimit nga krimi në anketë

Pyetjet e Anketës për të Drejtat Themelore fokusoheshin te përvojat e njerëzve me pesë lloje krimesh: vjedhjet me thyerje, mashtrimi me llogaritë bankare në internet ose me kartën bankare, mashtrimi ndaj konsumatorit, ngacmimi dhe dhuna. Raporti analizon rezultatet për secilin prej këtyre pesë llojeve.

Në përgjithësi, 54% e njerëzve në 27 shtetet anëtare të BE-së (BE-27) patën përvoja me një ose disa prej këtyre krimeve në pesëvjeçarin para kryerjes së anketës dhe 39% patën përvoja me to në një hark prej 12 muajsh para kryerjes së anketës. Brenda këtyre përqindjeve, shpeshësia e këtyre pesë llojeve të krimit ndryshon shumë.

Nga të pesta llojet e krimeve, përvojat më të shumta kanë qenë ato me ngacmimin (41% në harkun e pesë viteve para anketës), ndjekur nga mashtrimi ndaj konsumatorit (26%). Përvojat me vjedhjen me thyerje, me mashtrimin me llogaritë bankare në internet dhe kartat bankare janë më pak të shpeshta - më pak se një në 10 persona kanë pasur përvoja me krime të tilla në harkun e pesë viteve para anketës. Norma e përgjithshme e shpeshësisë së përvojave me krimin, në harkun kohor 5-vjeçar dhe në atë 12-mujor para anketës, lidhet ngushtë me përvojat e ngacmimit dhe mashtrimit ndaj konsumatorit, pasi ato janë më të përhapurat midis pesë llojeve të krimit të përfshira në anketë.

**FIGURA 1: PËRVOJAT ME TË PESË KRIMET E PËRFSHIRA NË ANKETË, NË HARKUN E PESË VITEVE DHE 12 MUJVE PARA ANKETËS (BE-27, %)**



Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me Centraal Bureau voor de Statistiek (CBS, NL), Centre de technologies de l'information de l'État (CTIE, LU) dhe Statistics Austria (AT)

Përveç pesë krimeve të renditura më lart, në Anketën për të Drejtat Themelore të anketuarit u pyetën nëse ndonjë funksionar publik ose nëpunës civil u ka kërkuar ose ka pretenduar prej tyre favore (p.sh. dhurata ose donacione) në këmbim të një shërbimi të caktuar. Një total prej 4% e njerëzve e kanë pasur këtë përvojë në pesë vitet e shkuara në BE-27. Megjithatë, përvojat ndryshojnë shumë nga një shtet anëtar i BE-së në tjetrin. **Raporti i parë i FRA-së mbi bazën e Anketës për të Drejtat Themelore** i analizon rezultatet në mënyrë më të detajuar.

# PËRJETIMET E DHUNËS

**Më shumë se 22 milionë persona në BE kanë përjetuar dhunë fizike në vitin para anketës.**

- ★ Afërsisht 1 në 10 persona (9%) në BE-27 kanë përjetuar dhunë fizike në harkun e pesë viteve para anketës dhe 6% përjetuan dhunë fizike në harkun e 12 muajve para anketës. Këto përqindje përkojnë me më shumë se 22 milion njerëz të cilët kanë përjetuar dhunë fizike brenda një viti në BE-27 (një shifër e përafërt bazuar në rezultatet e anketës për popullsinë e BE-së).
- ★ Këto rezultate përfshijnë të përjetuarit e një ose më shumë prej katër akteve të përgjithshme të dhunës fizike të përmendura në anketë: dikush ju ka qëlluar me pëllëmbë, ju ka goditur me një objekt, ju ka shtyrë ose ju ka shkulur flokët; dikush ju ka goditur një herë me grusht ose me diçka tjetër që mund t'ju kishte lënduar; dikush ju ka goditur me shkelm, ju ka tërhequr zvarrë ose ju ka rrahur; dikush është përpjekur t'ju mbysë ose t'ju zërrë frymën.
- ★ Përvojat ndryshojnë nga njëri vend i BE-së në tjetrin, duke u luhatur në një përqindje të popullsisë që kanë përjetuar dhunë fizike në harkun e pesë viteve para anketës, midis 3% dhe 18%. Këto dallime ndër shtetet anëtare duhet të interpretohen përkrah statistikave zyrtare për krimet e kallëzuara në polici në çdo shtet (gjë që shkon përtej fushëveprimit të këtij raporti) dhe përkrah të dhënave për modelet në kallëzimet e krimit, gjë që do të hulumtohet në një kapitull të veçantë të këtij raporti.
- ★ Krahasuar me grupmoshat e tjera dhe me karakteristikat e tjera socio-demografike që analizon anketa, të rinjtë (mosha 16–29 vjeç) janë grupi me rrezikun më të lartë për të përjetuar dhunë fizike. Rreth një në katër persona (23%) të moshës 16–29 vjeç kanë përjetuar dhunë fizike në harkun e pesë viteve para anketës. Në kategoritë e tjera të moshave, 1 në 10 persona, ose dhe më pak, kanë përjetuar dhunë fizike në të njëjtën hapësirë kohore.

## OPINIONI 1 I FRA-SË


Dhunë fizike është realitet shqetësues në të gjithë BE-në, siç e tregojnë të dhënat e anketës. Në pajtim me direktivën “Për të drejtat e viktimave”, shtetet anëtare duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të siguruar qasje në drejtësi për të gjitha viktimat e krimit, madje edhe për ato më të cenueshmet, duke u dhënë viktimave informacionin, mbështetjen dhe mbrojtjen e duhur dhe duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre në procedimet penale.

Shkalla e dhunës fizike e përjetuar nga të rinjtë është shumë më e lartë se ajo në grupmoshat e tjera. Kjo gjë justifikon veprimet nga ana e Shteteve Anëtare të BE-së për të siguruar që të rinjtë të informohen për të drejtat e tyre dhe për institucionin ku të drejtohen pas përjetimit të dhunës fizike. Në këtë grupmoshë, disa përvoja me dhunën mund të ndodhin në shkollë ose në institucionet e arsimit të mesëm dhe në të përfshihen bashkëmoshatarët e viktimave. Për shkak të këtij fakti, është me rëndësi të merren masa të përshtatura enkas për kontekste të veçanta.

Shtetet anëtare të BE-së duhet të zhvillojnë masa të posaçme për të parandaluar dhunën fizike ndaj personave me aftësi të kufizuara, pakicave etnike, lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjinjorëve dhe ndërgjinorëve, të cilët përjetojnë shkallë më të lartë dhune fizike dhe ngacmimi në krahasim me të tjerët. Përveç dhunës fizike në përgjithësi, këto grupe janë subjekt i incidenteve të nxitura nga urrejtja, siç theksohet në anketat e kryera enkas nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore me grupet specifike. Kjo gjë mund të ketë ndikim negativ në ndjesinë e sigurisë së këtyre grupeve.

- ★ Grupet e tjera që përjetojnë dhunën fizike në një shkallë më të lartë se mesatarja e të gjithë popullsisë përfshijnë persona që e konsiderojnë veten si pjesëtarë të një pakice etnike (22% në pesë vitet para anketës); persona që identifikojnë veten si lesbike, homoseksualë, biseksualë ose "tjetër" (19%) dhe persona që kanë kufizime në veprimtarinë e përditshme për shkak të problemeve shëndetësore ose aftësisë së kufizuar (17%).

**FIGURA 2: PËRVOJAT ME DHUNËN FIZIKE NË HARKUN E PESË VITEVE DHE NË HARKUN E 12 MUAJVE PARA ANKETËS, SIPAS SHTETIT (%)**



**Shënime:**

Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, Maqedoninë e Veriut dhe Mbretërinë e Bashkuar (n = 34 948); rezultate të ponderuara.

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)

Dhuna është shkelje e qartë e të drejtave të viktimës, veçanërisht e së drejtës për dinjitet njerëzor dhe së drejtës për integritet (nenet 2 dhe 3 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta)). Në pajtim me direktivën “Për të drejtat e viktimave”, viktimat e një krimi të dhunshëm duhet të konsiderohen si një person i cili ka pësuar padrejtësi nga kundërvajtësi, i cili duhet mbrojtur nga viktimizimi i përsëritur, të cilit i duhet dhënë qasje në drejtësi dhe i duhet dhënë mundësia të marrë pjesë në procedurat penale. Anketa tregon se një numër i madh njerëzish në BE përfshihen çdo vit dhunë fizike. Anketa e FRA-së mbi dhunën kundërshtet grave e mbështet këtë përfundim, ashtu siç e mbështesin edhe anketat e tjera të saj me në fokus përvojat e dhunës ndër grupet si imigrantët, pakicat etnike dhe personat e komunitetit LGBTI.

Ashtu siç pranohet edhe nga strategjia e parë e BE-së për të drejtat e viktimave (2020–2025), viktimat më të cenueshme si viktimat e dhunës me bazë gjinore, fëmijët viktimat, viktimat me aftësi të kufizuar ose viktimat e krimeve të urrejtjes e kanë tepër e vështirë t’u nënshtrohen procedurave penale dhe të përballen me pasojat e krimit. Në këtë kuadër, direktiva “Për të drejtat e viktimave” kërkon që të ngrihen strukturat e duhura për të ofruar shërbime të përgjithshme dhe të specializuara mbështetjeje, si dhe mbrojtje të përshtatur me nevojat specifike të viktimës. Për të identifikuar viktimat me nevojat të veçanta mbrojtjeje,

direktiva u kërkon shteteve anëtare t’u kushtojnë vëmendje të veçantë çështjeve që përfshijnë dhunë në një marrëdhënie të afërt dhe dhunë me bazë gjinore, dhunë seksuale, krime të nxitura nga urrejtja, krime të tjera që lidhen me karakteristikat personale të viktimave dhe çështjeve që përfshijnë viktimat me aftësi të kufizuar.

Kështu, në pajtim me nenet 8 dhe 9 të direktivës “Për të drejtat e viktimave”, viktimat me nevojat të veçanta duhet të kenë qasje te organizatat që ofrojnë mbështetje të specializuar dhe që kanë personel dhe financim të mjaftueshëm. Neni 18 parashikon gjithashtu masa të veçanta për të mbrojtur këto viktimat nga rreziqet e një viktimizimi dytësor (si rezultat i trajtimit të tyre nga policia dhe sistemi i drejtësisë penale), nga viktimizimi i përsëritur (kur ato viktimizohen përsëri), nga kanosja dhe nga hakmarrja (nga ana e autorëve të krimit).



Edhe akte të tjera të legjislationit dytësor të BE-së, si Vendimi Kuadër “Për racizmin dhe ksenofobinë”, nënvizojnë të drejtat e grupeve specifike të viktimave të cenueshme. Në rastin e viktimave fëmijë, direktiva “Për të drejtat e viktimave” i detyron shtetet anëtare të sigurohen që konsiderata parësore të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe se ky interes do të vlerësohet rast pas rasti. Qasja kryesore duhet të jetë ajo me në fokus fëmijën, duke marrë parasysh moshën, shkallën e pjekurisë, pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e fëmijës (neni 1, paragrafi 2).

Neni 16, paragrafi 4, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar u bën veçanërisht thirrje shteteve palë që të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu edhe dhënien e shërbimeve të mbrojtjes, për të nxitur rikuperimin fizik, konjitiv dhe psikologjik, rehabilitimin dhe riintegrimin shoqëror të personave me aftësi të kufizuar që bëhen viktimat të çfarëdo forme shfrytëzimi, dhune ose abuzimi.”

Për sa u takon instrumenteve politike, plani i veprimit të BE-së kundër racizmit për periudhën 2020–2025 përcakton veprimet konkrete për të trajtuar krimet e nxitura nga urrejtja raciale dhe gjuhën e urrejtjes, ndërsa kuadri strategjik i BE-së 2020–2030 për romët thekson përvojat me krimet e nxitura nga urrejtja raciale dhe me gjuhën e urrejtjes në popullsinë rome. Në strategjinë e BE-së 2020–2025 për barazinë e personave LGBTIQ, një nga katër fushat kryesore që duhen trajtuar është garantimi i sigurisë së personave lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë, pa identitet gjinor, ndërgjinorë dhe ata jo heteroseksualë (me gjini fluide).

# KONTEKSTI I DHUNËS - PËRQENDRIMI TE PËRVOJAT E GRAVE DHE BURRAVE

**Gratë përjetojnë dhunë fizike në shtëpi për pjesën më të madhe, ndërsa burrat shpesh përjetojnë dhunë në mjedise publike.**

## OPINIONI 2 I FRA-SË

Shtetet anëtare të BE-së duhet që, përveç masave të nevojshme për të inkurajuar dhe fuqizuar këto viktime që të kallëzojnë ngjarjen e krimit (shih **opinionin 5**), të konsiderojnë edhe marrjen e masave specifike për të siguruar mbështetje të posaçme për viktimat e dhunës në familje. Këto masa nevojiten për të siguruar që të drejtat e garantuara nga direktiva "Për të drejtat e viktimave" të jenë të efektshme në praktikë për ato viktime, kryesisht gra, që përjetojnë dhunë në familje nga pjesëtarët e familjes ose nga të afërm të tjerë dhe që rrjedhimisht kanë vështirësi të gjejnë mbështetje për të dalë nga cikli i dhunës dhe t'i qasen drejtësisë. Këtu mund të përfshihen trajnimet dhe udhëzimet specifike për profesionistët që janë në kontakt me viktimat (p.sh. profesionistët e kujdesit shëndetësor ose mësuesit) për mënyrat e identifikimit të krimit që ndodh brenda shtëpisë dhe trajtimit të tij në mënyrën e duhur. Në këtë kontekst, edhe Komisioni Evropian inkurajohet të bazohet në ekspertizën e Platformës së sapokrijuar për të Drejtat e Viktimave dhe të përdorë potencialin e kësaj platforme.

BE-ja dhe shtetet anëtare të BE-së, të cilat ende nuk e kanë ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" (Konventa e Stambollit), nxiten ta ratifikojnë atë. Paralelisht, institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare nxiten që të mbështeten tek të dhënat e Anketës për të Drejtat Themelore dhe tek anketa e mëparshme e FRA-së për dhunën ndaj grave, kur analizojnë mangësitë në legjislacionin ekzistues dhe mënyrat për të trajtuar në mënyrën më të efektshme dhunën me bazë gjinore gjatë procesit të miratimit të ligjeve dhe politikave aktuale, në pajtim me planin e veprimit të Komisionit, të përcaktuar në strategjinë e BE-së për të drejtat e viktimave dhe në Strategjinë për Barazinë Gjinore 2020-2025.

★ Incidentet e dhunës fizike ndaj burrave (duke përjashtuar në mënyrë specifike dhunën seksuale) kanë ndodhur më shpesh në ambiente publike (39%), për shembull në rrugë, parqe apo hapësira të tjera publike. Incidentet e dhunës fizike ndaj grave (përsëri duke përjashtuar në mënyrë specifike dhunën seksuale) kanë ndodhur më shpesh në ambientet e tyre të shtëpisë (37%).

★ Në rastin e burrave, këto incidente janë kryer më shpesh nga autorë që ata nuk i njohnin (42%). Nga ana tjetër, në rastin e dhunës fizike ndaj grave autori është kryesisht një anëtar i familjes ose një i afërm.

Rezultatet e kësaj ankete duhet të interpretohen krahas përfundimeve të mëparshme të anketës së FRA-së për dhunën ndaj grave, ku janë matur më me detaje përvojat e grave me dhunën, duke përfshirë dhunën nga partneri intim dhe dhunën seksuale, viktimat më të shumta të të cilave janë gratë.

★ Në shumicën e rasteve të dhunës fizike, autori ka qenë një burrë ose një grup burrash. Kështu ka ndodhur për 72% të incidenteve të dhunës fizike ndaj burrave dhe 60% të të njëjtave incidente ndaj grave.

Kur u pyetën nëse ndonjë prej rasteve të dhunës fizike përfshinte incidente me natyrë seksuale, kësaj pyetjeje iu përgjigjën pozitivisht më shumë gra (13%) se sa burra (10%). Këtu është me rëndësi të konstatojmë se, sipas të dhënave, viktimat e dhunës fizike përjetojnë më shpesh pasoja të ndryshme psikologjike dhe lëndime kur këto incidente përfshijnë akte me natyrë seksuale. Përgjithësisht, 51% e burrave raportojnë se incidenti më i fundit i dhunës fizike (joseksuale) nuk shkaktoi pasoja psikologjike, kundrejt 30% të grave. Në kontrast me shifrat e mëparshme, 34% e grave raportojnë se kanë përjetuar katër ose më shumë lloje pasojash psikologjike pas një incidenti dhune fizike që përfshinte edhe elemente me natyrë seksuale, kundrejt 9% të burrave.


Rezultatet e anketës shfaqin disa dallime kyçe midis përvojave të grave dhe burrave me dhunën. Këto dallime kanë pasojë të rëndësishme lidhur me ndikimin që kanë te viktimat dhe me qasjen e viktimës te drejtësia. Kur dhuna ndodh në mjedise publike, ndodh shpesh që të ketë njerëz të tjerë në afërsi, të cilët mund të ndërhyjnë ose të shërbejnë si dëshmitarë. Ndërsa për dhunën e ushtruar në shtëpi shpesh nuk ndodh kështu. Kjo do të thotë se, mesatarisht, gratë dhe burrat e gjejnë veten në pozita të ndryshme si viktimat të dhunës kur kërkojnë ndihmë, kur kallëzojnë incidentet në polici ose kur këto incidente shqyrtohen në gjykatë.

Pikërisht në këtë kontekst strategjia e BE-së për të drejtat e viktimave 2020–2025 u kushton vëmendje të veçantë veprimeve që nevojiten për t’iu përgjigjur nevojave specifike të viktimave të dhunës me bazë gjinore. Kjo strategji përmbledh veprimet që synojnë fuqizimin e të drejtave të këtij grupi viktimash, madje edhe përmes përforsimit të mbrojtjes fizike; krijimin e një rrjeti të BE-së për parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe financimin nga ana e BE-së. Platforma për të Drejtat e Viktimave sjell së bashku të gjitha organet në nivel BE-je të cilat merren me të drejtat e viktimave. Përmes Platformës, Komisioni synon të mundësojë edhe shkëmbimin e vazhdueshëm të praktikave më të mira dhe ndërthurjen midis strategjisë së BE-së për të drejtat e viktimave dhe Strategjisë Evropiane për Barazinë Gjinore 2020–2025, për shembull.

Duke pranuar se kryesisht autorët e dhunës janë burra dhe në pajtim me nenin 84 (për parandalimin e krimit) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, BE-ja duhet të nxisë dhe mbështesë veprimet e shteteve anëtare në fushën e parandalimit të krimit. Këto veprime duhet të synojnë prezantimin e masave për edukimin e djemve të vegjël dhe të rinj në mënyrë të tillë që t’u mësohet zgjidhja e konflikteve pa dhunë ose sjellje abuzive dhe trajtimi i vajzave dhe grave (djemve dhe burrave po ashtu) me respekt, duke u mbështetur te vlerat lidhur me të drejtat e njeriut si dinjiteti njerëzor, barazia dhe mosdiskriminimi.

Shtetet anëtare inkurajohen të përgatitin sanksione penale që kanë potencialin për të rehabilituar meshkujt autorë të krimeve dhe për t’i mbështetur ata që të zhvillohen si persona të përgjegjshëm dhe të respektueshëm. Këtu mund të përfshihen trajnimet kundër dhunës që i japin vëmendjen e duhur roleve të gjinive dhe stereotipive lidhur me agresivitetin mashkullor. Shtetet anëtare që ende nuk e kanë bërë, në pajtim me nenin 18 të direktivës “Për të drejtat e viktimave”, nxiten të konsiderojnë integrimin e trajnimeve për çështjet gjinore dhe kundër dhunës si sanksion penal, me qëllim uljen e shkallës së viktimizimit të përsëritur.

**FIGURA 3: GJINIA E AUTORËVE TË DHUNËS, INCIDENTET E PËRJETUARA NGA BURRAT DHE GRATË (BE-27, %)**



Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)

Në pajtim me nenet 8 dhe 9 të direktivës “Për të drejtat e viktimave”, gratë që përjetojnë dhunë në shtëpi nga anëtarët e familjes ose nga të afërmit dhe që, rrjedhimisht, e kanë të vështirë të gjejnë mbështetje për të dalë nga cikli i dhunës dhe t’i qasen drejtësisë, duhet të përfitojnë mbështetjen e organizatave që ofrojnë mbështetje të specializuar dhe që kanë personel dhe financim të mjaftueshëm. Neni 18 parashikon gjithashtu masa të veçanta për të mbrojtur këto viktime nga rreziqet e një viktimizimi dytësor, nga viktimizimi i përsëritur, nga kanosja dhe hakmarrja.



Duke qenë se rezultatet e anketës nënvizojnë natyrën gjinore të dhunës, të përjetuar ndryshe nga burrat dhe gratë, përfundimet mund të interpretohen paralelisht me dokumentet specifike për të drejtat e njeriut të cilët theksojnë nevojën për një arsim sensitiv ndaj gjinisë. Për shembull, neni 10 i Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” (CEDAW) i detyron shtetet e saj palë që të sigurojnë në arsim eliminimin e çdo koncepti të stereotipizuar për rolin e burrave dhe të grave dhe neni 14 i Konventës së Stambollit thekson rëndësinë e një arsimit që të nxisë barazinë midis grave dhe burrave, mungesën e stereotipave në rolet gjinore, respektin e ndërsjellë dhe zgjidhjen pa dhunë të konflikteve në marrëdhëniet ndërpersonale.

Në fakt, deri më sot, Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës konsiderohet si instrumenti ndërkombëtar më gjithëpërfshirës për dhunën ndaj grave. Ajo përcakton masat që kanë rëndësi kritike në luftën ndaj dhunës midis partnerëve intimë si p.sh. mbrojtje penale që shënjestron dhunën midis partnerëve intimë, një sistem efektiv për urdhrat e mbrojtjes dhe organizata që ofrojnë mbështetje të specializuar për të gjitha gratë viktime të partnerëve ose ish-partnerëve të dhunshëm. Në momentin e hartimit të këtij raporti, Konventa e Stambollit është ratifikuar nga 21 shtete anëtare të BE-së dhe është nënshkruar, por ende nuk është ratifikuar nga gjashtë shtete.<sup>1</sup> Edhe BE-ja e ka nënshkruar konventën, por ende nuk e ka ratifikuar.

Në zbatim të strategjisë së BE-së për të drejtat e viktimave, shtetet anëtare duhet të hartojnë strategji kombëtare për të drejtat e viktimave të cilat duhet të sigurojnë një qasje horizontale dhe të bashkërenduar për të drejtat e viktimave, duke përfshirë integrimin e të drejtave të viktimave në politika, si p.sh. në atë të arsimit.

<sup>1</sup> Që prej janarit 2021, Konventa e Stambollit është ratifikuar nga këto shtete anëtare të BE-së: Austria, Belgjika, Kroacia, Qiproja, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja dhe Suedia. Gjithashtu, ndër vendet e përfshira në Anketën për të Drejtat Themelore që e kanë ratifikuar konventën është gjithashtu edhe Maqedonia e Veriut. Shtetet e mëposhtme anëtare të BE-së e kanë nënshkruar konventën, por ende nuk e kanë ratifikuar atë: Bullgaria, Çekia, Hungaria, Letonia, Lituania dhe Sllovakia. Po ashtu, edhe Mbretëria e Bashkuar e ka nënshkruar, por ende nuk e ka ratifikuar konventën.

# PËRVOJAT ME NGACMIMIN

**Më shumë se 110 milionë njerëz në BE kanë përjetuar forma të ndryshme ngacmimi në vitin para anketës.**

- ★ Në pesë vitet para anketës, dy në pesë persona (41%) në BE-27 kanë përjetuar ngacmimin, i cili përfshin si komentet fyese dhe kërcënuese të bëra ballë për ballë ashtu dhe gjestet fyese dhe kërcënuese të dërguara në internet, madje edhe përmes mediave sociale. Në 12 muajt para anketës, 29% e personave kanë përjetuar ngacmim. Kjo përqindje përkon me thuajse 110 milionë njerëz të cilët kanë përjetuar ngacmimin në BE-27 brenda një viti (një shifër e përafërt bazuar në rezultatet e anketës për popullsinë e BE-së).
- ★ Përvojat me ngacmimin variojnë nga 46% në 9%, sipas vendit (në 12 muajt para anketës).
- ★ Forma më e zakonshme e ngacmimit që përjetojnë njerëzit në BE përfshin komentet fyese ose kërcënuese të bëra ballë për ballë. Ky lloj ngacmimi është përjetuar nga 32% e personave në pesë vitet para anketës.
- ★ Në përgjithësi, 14% e njerëzve në BE kanë përjetuar ngacmim kibernetik në pesë vitet para anketës. Këtu mund të përfshihet marrja e emailve ose mesazheve fyese apo kërcënuese ose të gjendurit përballë komenteve fyese apo kërcënuese për veten të shpërndara në internet.
- ★ Tre në pesë njerëz (61%) të grupmoshës 16–29 vjeç kanë përjetuar ngacmim në pesë vitet para anketës. Përgjithësisht, në të njëjtën grupmoshë dhe afat kohor, 27% kanë përjetuar ngacmim kibernetik. Këto janë përqindjet më të larta në të gjitha grupmoshat, duke pasur parasysh se ngacmimi ulet me rritjen në moshë.
- ★ Teksa shpeshtësia e ngacmimit është e ngjashme për femrat dhe meshkujt, 18% e femrave e përshkruan incidentin më të fundit të ngacmimit si ngacmim me natyrë seksuale, në krahasim me 6% të meshkujve.
- ★ Ndërsa norma mesatare e ngacmimit është 41% (në një hark pesëvjeçar), kur zbërthehen të dhënat sipas grupeve specifike socio-demografike dalin në pah norma më të larta (për të njëjtën periudhë): 57% për personat që e identifikojnë veten si lesbike, homoseksual, biseksual ose "tjetër"; 54% për personat pa shtetësinë e vendit ku jetojnë; 51% për ata që kanë lindur në një tjetër shtet anëtar të BE-së; 49% për ata që kanë lindur jashtë BE-së dhe 50% për personat me aftësi të kufizuara (personat që kanë vështirësi në veprimtaritë që njerëzit e tjerë i kryejnë normalisht, për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar).

## OPINIONI 3 I FRA-SË

Nisur nga përhapja e gjerë e ngacmimit, BE-ja duhet të konsiderojë rishikimin e reagimit të legjisllacionit dhe politikave ekzistuese ndaj ngacmimit, duke përfshirë ngacmimin seksual, si dhe ndaj të gjitha mjediseve të mundshme ku ndodh ngacmimi (përfshirë këtu internetin), duke përfshirë edhe ngacmimin përtej vendit të punës dhe fushës së arsimit.

Për shkak të ndikimit tepër të madh të ngacmimit tek të rinjtë, veçanërisht të ngacmimit kibernetik, shtetet anëtare të BE-së duhet të sigurojnë që viktimat e këtij ngacmimi të kenë qasje në metoda të thjeshta dhe të efektshme për të kallëzuar incidentet dhe që ato t'i nënshtrohen hetimit. BE-ja mund t'i mbështesë shtetet anëtare në këtë aspekt, duke i ndihmuar që të sigurojnë hartimin e rregullave të harmonizuara për të trajtuar përmbajtjen e paligjshme në internet, duke përfshirë nxitjen e dhunës, urrejtjes dhe diskriminimit, për shembull me anë të Aktit të ardhshëm të Shërbimeve Dixhitale.


Duke pasur parasysh provat e paraqitura në këtë raport dhe në raporte të tjera të FRA-së për ndikimin e ngacmimit të nxitur nga urrejtja në grupe të ndryshme të shoqërisë, shtetet anëtare të BE-së duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të mbrojtjes së parashikuar nga direktiva "Për të drejtat e viktimave", e cila i trajton të gjitha viktimat e krimit në mënyrë të barabartë, pavarësisht motivit të pretenduar nga autorët e krimeve. Kjo gjë do të ishte në pajtim me parimin e mos-diskriminimit, sipas të cilit masat e legjisllacionit penal duhet të mbulojnë në mënyrë të barabartë të gjitha arsyet e diskriminimit të mbuluara nga neni 21 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Kjo do të ishte në pajtim edhe me planet e Komisionit për të propozuar zgjerimin e listës së veprave penale në BE, me qëllimin për të përfshirë aty të gjitha format e krimeve të urrejtjes dhe të gjuhës së urrejtjes.

- ★ Ngacmimi që nuk përfshin akte me natyrë seksuale shpesh bëhet nga dikush që viktimat nuk e njeh (në 52% të incidenteve të përjetuara nga femrat dhe 59% të incidenteve të përjetuara nga meshkujt). Megjithatë, femrat kanë më shumë gjasa të përjetojnë ngacmim ku përfshihen akte me natyrë seksuale nga autorë të panjohur më parë: 72% e incidenteve të ngacmimit me natyrë seksuale kundër grave janë kryer nga persona të panjohur, krahasuar me 40% të incidenteve kundër burrave. Gjithashtu, 57% e grave raportojnë se ngacmimi ku përfshihen aktet me natyrë seksuale ka ndodhur në publik - në rrugë, park ose një vend tjetër publik - krahasuar me 30% të incidenteve me natyrë seksuale të përjetuar nga burrat.
- ★ Në incidentet e ngacmimit ku nuk ka pasur akte me natyrë seksuale, 77% e burrave dhe 58% e grave raportojnë se autori ishte burrë (ose një grup burrash).

Shënime:

Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, Maqedoninë e Veriut dhe Mbretërinë e Bashkuar (n = 34 948); rezultate të ponderuara.

**FIGURA 4: PËRVOJAT ME NGACMIMIN NË HARKUN E PESË VITEVE DHE NË HARKUN E 12 MUAJVE PARA ANKETËS, SIPAS SHTETIT (%)**



Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)

Anketa tregon se mjaft njerëz në BE janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të ngacmimit, por kur popullsia ndahet në grupe specifike ka dallime të konsiderueshme.

Në mënyrë të veçantë, të rinjtë përjetojnë ngacmimin në një shkallë shumë më të lartë se personat më të moshuar, përfshirë këtu incidentet e ngacmimit kibernetik. BE-ja ka marrë tashmë një masë për këtë çështje: ndryshimi i direktivës “Për shërbimet e mediave audiovizive” në vitin 2018 përcakton se duhet mbrojtur më mirë zhvillimi moral i të miturve. Për më tepër, Komisioni Evropian ka bërë të ditur synimin e tij për të propozuar një paketë të quajtur Akti i Shërbimeve Dixhitale, për të modernizuar kuadrin ligjor të përkufizuar në direktivën “Për tregtinë elektronike” (Direktiva 2000/31/KE). Përveç çështjeve të tjera, paketa Akti i Shërbimeve Dixhitale do të përfshinte rregullat për mënyrën e trajtimit të përmbytjes së paligjshme në internet (për shembull nxitja e paligjshme e dhunës, urrejtjes ose diskriminimit për shkak të motiveve të mbrojtura me ligj si raca, etnia, gjinia ose orientimi seksual). Në rezolutën e tij për Strategjinë e BE-së për Rininë 2019–2027, Këshilli i BE-së vëren nevojën për të siguruar që të rinjtë të kenë aftësinë për të dalluar dhe denoncuar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit në internet dhe jashtë tij.<sup>2</sup>



Nga ana tjetër, të gjithë personat me probleme serioze shëndetësore ose me aftësi të kufizuar, personat që janë lindur jashtë vendit ose me origjinë nga një pakicë etnike dhe personat e komunitetit LGBTI kanë përjetuar ngacmim në shkallë më të lartë se mesatarja. Ndoshta kjo vjen pjesërisht edhe nga ekspozimi i këtyre grupeve ndaj ngacmimit të motivuar nga urrejtja. Në këtë kuadër, Vendimi Kuadër i vitit 2008 “Për Racizmin dhe Ksenofobinë” pranon pjesërisht nevojën për të mbrojtur grupe njerëzish ose anëtarë të këtyre grupeve – të përkufizuar nisur nga raca, ngjyra, feja, prejardhja ose origjina kombëtare apo etnike – nga nxitja e dhunës dhe urrejtjes. Megjithatë, sipas të dhënave të anketës, grupe të tjera të ekspozuara ndaj niveleve të larta të ngacmimit, si personat me probleme shëndetësore serioze ose aftësi të kufizuar dhe personat e komunitetit LGBTI, nuk kanë të njëjtin

nivel mbrojtjeje nga legjislacioni i BE-së nga krimet e mundshme të motivuara nga urrejtja. Të referuarit e viktimave të “krimit për shkak të paragjykitimit ose të një arsyeje diskriminuese” (neni 22, paragrafi 3) në direktivën “Për të drejtat e viktimave” në njëfarë mënyrë shkon drejt trajtimit të këtij realiteti, pasi i sjell të gjitha viktimat e krimit nga urrejtja në të njëjtin nivel, pavarësisht motivit të pretenduar nga autorët e krimit.

Në programin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2021 janë njoftuar zhvillime të mëtejshme legjislative për të gjithë BE-në në këtë fushë. Këtu bëhet fjalë për një nismë të re për të përfshirë në listën e veprave penale në BE të gjitha format e krimit nga urrejtja dhe të gjuhës së urrejtjes, qofshin këto për shkak të racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual apo për shkak të arsyeve të tjera.

Ngacmimi ka natyrë gjinore. Gratë pësojnë në shkallë shumë të gjerë ngacmim me natyrë seksuale nga të panjohur. Këto incidente kryhen kryesisht nga burrat dhe të dhënat tregojnë se incidentet shpesh ndodhin në mjedise publike. Fushëveprimi ekzistues i legjislacionit të BE-së në fushën e barazisë gjinore e kufizon njohjen e ngacmimit – dhe të natyrës së tij gjinore – në tregun e punës dhe në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve.<sup>3</sup> Në deklamimin 17, direktiva “Për të drejtat e viktimave” e njëh ngacmimin seksual si lloj të dhunës me bazë gjinore, e cila është formë diskriminimi dhe shkeljeje e të drejtave themelore të viktimës, dhe për rrjedhojë e shtrin mbrojtjen e saj të viktimat e ngacmimit seksual.

<sup>2</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian (2018), Rezoluta e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe e Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare për takimin me Këshillin lidhur me kuadrin e bashkëpunimit evropian në fushën e rinisë: Strategjia e Bashkimit Evropian për Rininë 2019–2027 (2018/C 456/01), Gazeta Zyrtare C 456.

<sup>3</sup> Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 korrik 2006 “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit” (reformular); Direktiva e Këshillit 2004/113/KE, datë 13 dhjetor 2004 “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; Direktiva 2010/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 7 korrik 2010 “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të përfshirë në veprimtari si të vetëpunësuar dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 86/613/KEE”.

# PËRVOJAT ME DISA LLOJE KRIMESH KUNDËR PRONËS DHE ME MASHTRIMIN

**Një në gjashtë persona (16%) në BE ka përjetuar mashtrimin ndaj konsumatorit në vitin para anketës.**

## OPINIONI 4 I FRA-SË

BE-ja dhe shtetet anëtare duhet t'i kushtojnë vëmendje të vazhdueshme krimit kundër pronës, madje edhe krimit ndërkufitar, duke përdorur rrjetet e ndryshme që janë ngritur në BE, madje edhe Rrjetin e BE-së për Parandalimin e Krimit. Në këtë kontekst, BE-ja dhe shtetet anëtare duhet të marrin gjithashtu në konsideratë kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e mjeteve për të parandaluar krimin kundër pronës, përfshirë vjedhjet me thyerje dhe mashtrimet bankare në internet dhe ato me kartat bankare.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të zbatojnë me efektshmëri legjislacionin ekzistues të BE-së në këtë fushë, duke përfshirë këtu legjislacionin për parandalimin e mashtrimit dhe atë për konsumatorin. Rezultatet e anketës mund të përdoren si udhëzues për përpjekjet e tyre. Për shembull, shtetet anëtare të BE-së duhet të konsiderojnë krijimin ose forcimin e ekipeve ekzistuese të specialistëve për të hetuar me efektivitet mashtrimin në internet, duke siguruar që viktimat e krimeve në internet të mund t'i kallëzojnë lehtësisht incidentet. Ato to duhet të konsiderojnë gjithashtu masa për ta përshtatur mbrojtjen e konsumatorit me realitetin e sotëm, sidomos lehtësinë e kryerjes së transaksioneve ndërkufitare dhe ato në internet në raport me mashtrimin ndaj konsumatorit (në internet), në pajtim me Axhendën e Re të Konsumatorit 2020-2025.

Autoritetet kombëtare përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë shkallës më të lartë të vjedhjes me thyerje, mashtrimit bankar në internet dhe me kartat e pagesave si dhe mashtrimit ndaj konsumatorit ndër personat me kufizime në veprimtaritë e tyre të përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar), për të trajtuar problematikat e një prej kategorive më të cenueshme të shoqërisë.

### Vjedhja me thyerje

- ★ Në përgjithësi, 8% e njerëzve në BE-27 kanë përjetuar vjedhje me thyerje në banesë ose në një pronë tjetër në pesë vitet para anketës. Ndërkohë, 3% kanë përjetuar vjedhje në banesë në hapësirën e 12 muajve para anketës.
- ★ Në varësi të vendit, përvojat me vjedhjen me thyerje (në pesë vitet para anketës) variojnë nga 14% në 2%.
- ★ Disa kategori shoqërore përjetojnë shkallë më të lartë vjedhjeje me thyerje krahasuar me të tjerat. Këtu përfshihen personat që kanë kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar) dhe personat që e identifikojnë veten si anëtarë të një pakice etnike. Dallimet në gjininë, moshën, arsimin, statusin urban/rural dhe në aftësinë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme mujore nuk lidhen me dallimet në shkallën e përjetimit të vjedhjes me thyerje në pesë vitet para anketës.

### Mashtrimi


- ★ Në BE-27, 8% e personave kanë pësuar mashtrimin bankar në internet dhe mashtrimin me kartat e pagesave (domethënë me kartat e kreditit ose të debitit) në pesë vitet para anketës. Ndërkohë, 3% kanë pësuar mashtrim bankar në internet dhe mashtrim me kartat e pagesave në hapësirën e 12 muajve para anketës.
- ★ Përvojat me mashtrimin bankar në internet dhe me kartat e pagesave variojnë nga 19% në 1%, në varësi të shtetit. Pjesërisht, këto shifra mund të shpjegohen nga shkalla e kryerjes së transaksioneve në internet në shtetet anëtare të marra individualisht.
- ★ Shkalla e përjetimit të mashtrimit bankar në internet dhe mashtrimit me kartat e pagesave nuk ndryshon shumë për sa i takon pjesën më të madhe të karakteristikave socio-demografike të marra në shqyrtim. Megjithatë, 14% e personave me kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar) kanë pësuar mashtrimin bankar në internet dhe mashtrimin me kartat e pagesave në pesë vitet para anketës, krahasuar me 6% të personave që nuk i kanë këto kufizime.
- ★ Një në katër persona (26%) në BE-27 ka pësuar mashtrim ndaj konsumatorit në pesë vitet para anketës. Këtu përfshihet rënia pre ndaj mashtrimit ose keqinformimit për sasinë, cilësinë, çmimin ose lëvrimin e mallrave, artikujve ose shërbimeve të blera. Në 12 muajt para anketës, 16% kanë pësuar mashtrim ndaj konsumatorit.
- ★ Në varësi të vendit, përvojat me mashtrimin ndaj konsumatorit (në pesë vitet para anketës) variojnë nga 46% në 8%.

- ★ Ndërmjet grupeve të analizuara socio-demografike, të rinjtë dhe ata me nivel të lartë arsimor përjetojnë nivele më të larta të mashtrimit ndaj konsumatorit sesa grupet e moshave më të mëdha dhe ata me nivel të ulët arsimor. Kjo mund të pasqyrojë ekspozimin ndaj riskut, shoqëruar me ndërgjegjësimin më të madh ndaj problemit të mashtrimit, pasi në BE-27 përdoruesit e internetit të moshave nga 16 deri 29 vjeç që bëjnë blerje në internet janë në masën 81%, krahasuar me 56% të përdoruesve të internetit të moshës 65 vjeç e lart.
- ★ Personat që kanë kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar) përjetojnë nivele më të larta të mashtrimit ndaj konsumatorit (36% në pesë vitet para anketës), krahasuar me personat që nuk i kanë këto kufizime (23%). Nivelet më të larta lidhen edhe me të qenët anëtar i një pakice etnike (37%) dhe me vetë-identifikimin si lesbike, homoseksual, biseksual ose "tjetër" (joheteroseksual) (35%).
- ★ Gjatë përshkrimit të incidentit më të fundit të mashtrimit ndaj konsumatorit, dy në pesë persona (41%) që kishin blerë mallra ose shërbime nga interneti, me telefon ose me postë, raportuan se i kishin porositur mallrat ose shërbimet jashtë shtetit. Në disa shtete anëtare të BE-së, shkalla e blerjeve ndërkufitare ishte shumë më e lartë: 94% në Luksemburg dhe 87% në Maltë.

#### Shënime:

Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, në Maqedoninë e Veriut dhe Mbretërinë e Bashkuar (n = 34 948); rezultate të ponderuara.

**FIGURA 5: PËRVOJAT ME MASHTRIMIN NDAJ KONSUMATORIT NË HARKUN E PESË VITEVE DHE NË HARKUN E 12 MUAJVE PARA ANKETËS, SIPAS SHTETIT (%)**



Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)

Përvoja me vjedhjen me thyerje në banesë ose në një pronë tjetër mund t'u shkaktojë viktimave ndjesinë e pasigurisë dhe të frikës se ngjarja mund të ndodhë përsëri. Ky krim ka edhe ndikime ekonomike – humbje të pronës ose dëme në banesë –me të cilat njerëzit përballen në mënyra të ndryshme, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe të mbulimit nga sigurimi. Vjedhja me thyerje shkel të drejtën e pronës (neni 17 i Kartës), të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 7) dhe të drejtën për dinjitet njerëzor (neni 1). Prandaj viktimat kanë të drejtë për një përgjigje nga ana e drejtësisë penale ndaj viktimizimit të tyre, që të shërbejë si zgjidhje ligjore e efektshme në përputhje me nenin 47 të Kartës dhe direktivën “Për të drejtat e viktimave”.

Një numër i përafërt njerëzish në BE përjeton keqpërdorim të llogarive të tyre bankare në internet ose të kartave të pagesës. Kjo tregon rëndësinë e barabartë të mashtrimit në internet në përvojat me viktimizimin. Rezultatet e anketës për mashtrimin bankar në internet dhe me kartat e pagesave janë me rëndësi për shtetet anëtare të BE-së në kuadër të zbatimit nga ana e tyre të masave të përcaktuara në direktivën “Për luftën kundër mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës jo me para në dorë” (Direktiva (BE) 2019/713), të cilën shtetet anëtare kanë afat ta trupëzojnë në legjislacionin kombëtar deri më 31 maj 2021. Nivelet më të larta të mashtrimit me llogaritë bankare në internet dhe me kartat e pagesës kundrejt personave me kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar) ngrenë shqetësime rreth shfrytëzimit të kategorive nga më të cenueshmet në shoqëri. Kjo çështje lidhet me nenin 16 (“Liria nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi”) të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD).

Neni 38 i Kartës dhe legjislacioni dytësor përkatës i BE-së (si Direktiva “Për praktikatat e padrejta tregtare biznes-konsumator në tregun e brendshëm”) parashikon përgjithësisht një nivel më të lartë mbrojtjeje për konsumatorin. Megjithatë, një në katër persona (26%) në BE-27 ka pësuar mashtrim ndaj konsumatorit në pesë vitet para anketës, që do të thotë se ata ndihen të mashtruar ose të keqinformuar për sasinë, cilësinë, çmimin ose lëvrimin e mallrave, artikujve ose shërbimeve që kanë blerë. Ky lloj mashtrimi nuk përfshin gjithmonë veprimtari kriminale, por rezultati përfundimtar është një konsumator që ndien se pritshmëritë e tij për produktin ose shërbimin që ka paguar nuk janë përmbushur. Kur këtu përfshihen veprimtari kriminale, direktiva “Për të drejtat e viktimave” parashikon të drejtat e viktimave të mashtrimit ndaj konsumatorit që ato të përfitojnë mbrojtjen e duhur, mbështetjen dhe qasjen në gjykatë, ashtu si të gjitha viktimat e tjera të krimit.

Në mënyrë të veçantë, rezultatet na zbulojnë edhe një volum të lartë transaksionesh ndërkufitare kur mallrat ose shërbimet blihen në internet, me telefon ose nëpërmjet postës. Këtu nënvizohet nevoja që masat në mbrojtje të konsumatorit të funksionojnë me efektshmëri në këto raste. Ashtu si në rastin e mashtrimit me llogaritë bankare në internet dhe me kartat e pagesave, personat me kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar) përjetojnë nivele më të larta të mashtrimit ndaj konsumatorit, prandaj kanë nevojë për mbrojtje dhe mbështetje të veçantë për t'iu qasur drejtësisë në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Nevoja për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, edhe përmes fuqizimit të tyre dhe zbatimit më efektiv të ligjit, është një nga problematikat kyçe që BE-ja po e diskuton aktualisht në kontekstin e Axhendës së re të Komisionit për Konsumatorin, për periudhën 2020-2025.



# KALLËZIMI I PËRVOJAVE ME KRIMIN PRANË POLICISË DHE AUTORITETEVE TË TJERA

**Shumica e incidenteve të dhunës fizike dhe ngacmimit nuk kallëzohen në polici.**

- ★ Gjatë përshkrimit të incidentit më të fundit kriminal të përjetuar në pesë vitet para anketës, 30% e njerëzve në BE-27 kallëzuan në polici dhunë fizike dhe 11% kallëzuan një incident ngacmimi.
- ★ Shkalla e kallëzimit të dhunës fizike në polici varion nga 40% në 9%, sipas shtetit, për incidentin më të fundit të ndodhur në pesë vitet para anketës. Pjesërisht, këto përqindje mund të pasqyrojnë nivelin e besimit në aftësinë ose vullnetin e policisë për ta përndjekur krimin. Shkalla e kallëzimit të ngacmimit pranë cilitdo autoritet (përfshirë policinë) varion nga 31% në 5%, sipas shtetit, për incidentin më të fundit të ndodhur në pesë vitet para anketës.
- ★ Përveç kallëzimit të incidenteve të dhunës fizike në polici, 17% e viktimave kanë qenë në kontakt me shërbimet mjekësore si pasojë e incidentit dhe 6% e tyre kanë kontaktuar organizatat që ofrojnë mbështetje të specializuar për viktimat.
- ★ Shkalla e kallëzimit varion sipas karakteristikave socio-demografike. Personat që kanë të ardhura të mira ose shumë të mira në familjen e tyre, studentët dhe personat që jetojnë në zonat rurale janë më të prirur se të tjerët për të mos i kallëzuar incidentet e dhunës që kanë përjetuar. Në të kundërt, personat me kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar), personat që i përkasin një pakice etnike dhe ata që vetë-identifikohen si lesbike, homoseksuale, biseksuale ose "tjetër" janë më të gatshëm të kallëzojnë në polici sesa ata që nuk e konsiderojnë veten si pjesëtarë të këtyre grupeve. Kjo gjë mund të pasqyrojë nivelet e krimeve të urrejtjes që përjetojnë nga këto grupe specifike.
- ★ Elementet e dhunës fizike që mund të dëftojnë incidente më të rënda shoqërohen me nivele më të larta kallëzimi. Në mënyrë të veçantë, në polici u kallëzuan 60% e incidenteve të dhunshme me natyrë seksuale, krahasuar me 27% të incidenteve që nuk ishin me natyrë seksuale. Shkalla e kallëzimit është më e ulët se mesatarja kur autori i krimit është anëtar i familjes ose një i afërm (vetëm 22% e incidenteve u kallëzuan në polici). Kjo shkallë kallëzimi është e dhënë domethënëse për moskallëzimin e dhunës në familje dhe/ose dhunës midis partnerëve intimë.

## OPINIONI 5 I FRA-SË

Shtetet anëtare të BE-së duhet të marrin në konsideratë prezantimin e masave specifike për të inkurajuar dhe fuqizuar njerëzit që të kallëzojnë krimin, në veçanti incidentet e dhunës dhe ngacmimit, pasi shkalla e kallëzimit të këtyre krimeve është më e ulët krahasuar me krimet e tjera. Ky është një kusht i rëndësishëm për të siguruar qasje të efektshme të drejtësisë, sepse në këtë mënyrë viktimat e krimit mund të informohen për të drejtat e tyre dhe për mbështetjen që mund t'u jepet. Masat për të inkurajuar njerëzit që të kallëzojnë krimin duhet të marrin parasysh rezultatet e anketës për arsyet e moskallëzimit të krimit dhe për shkallën më të ulët të kënaqësisë ndër personat jo shtetas kur kallëzojnë incidentet e ngacmimit.

Në prezantimin e masave të tilla, shtetet anëtare të BE-së duhet të pranojnë se marrëdhënia midis autorit të krimit dhe viktimës ndikon te gjasat për të kallëzuar pranë policisë incidente si dhuna në familje ose dhuna midis partnerëve intimë. Siç u theksua në [opinionin 2](#), duhen bërë të gjitha përpjekjet për të inkurajuar dhe lehtësuar kallëzimin e këtyre krimeve dhe për t'u bërë të mundur viktimave të prishin ciklin e viktimizimit të vazhdueshëm. Në këtë kontekst, shtetet anëtare duhet të marrin parasysh edhe mundësitë për t'u ofruar ndihmë dhe këshillim për të drejtat viktimave të krimit të cilat, pasi ka ndodhur incidenti, kontaktojnë shërbime të tjera të ndryshme nga policia, si p.sh. ofruesit e kujdesit shëndetësor.

Për regjistrimin e krimeve të ndodhura dhe raportimin e situatës në vend, shtetet anëtare të BE-së mund të përdorin mekanizma raportimi të palëve të treta për të zbuluar sa më shumë incidente. Ndryshe, disa prej këtyre incidenteve nuk do të sillleshin në vëmendje të policisë, si p.sh. incidentet të cilat viktimat, për një arsye ose një tjetër, nuk i perceptojnë si aq "serioze" sa të kontaktojnë policinë.

- ★ Tre në pesë persona (62%) që kanë kallëzuar ngacmimin në polici, kanë qenë të kënaqur me mënyrën e trajtimit të incidentit nga policia, ashtu siç ishin të kënaqur edhe 63% e personave që kallëzuan në polici incidentin më të fundit të dhunës fizike. Megjithatë, vetëm 42% e viktimave të ngacmimit që nuk kishin shtetësinë e vendit ku jetojnë ishin të kënaqur me mënyrën e trajtimit të incidentit nga policia në momentin e kallëzimit të krimit, krahasuar me 63% të shtetasve të atij vendi.
- ★ Për sa i përket moskallëzimit të dhunës dhe ngacmimit në polici, arsyeja më e zakonshme që u përmend ishte se incidenti nuk konsiderohej aq serioz sa të merrnin mundimin për ta kallëzuar. Ndër arsyeve për të mos kallëzuar dhunën fizike në polici kur viktimë ka pësuar lëndime, një në katër persona (23%) raportuan se nuk besonin se policia do të bënte ndonjë gjë dhe 14% përmendën mosbesimin te policia.
- ★ Krimet ndaj pronës kallëzohen, pranë policisë dhe autoriteteve të tjera, në një shkallë më të lartë se dhuna dhe ngacmimi. Në BE-27, u kallëzuan në polici 73% e vjedhjeve me thyerje, ndërsa 95% e mashtrimeve me veprimet bankare në internet dhe me kartat e pagesave u kallëzuan pranë policisë dhe autoriteteve të tjera. Në tërësi, në BE-27 u kallëzuan 50% e incidenteve të mashtrimit ndaj konsumatorit, por në shumicën e rasteve kallëzimi u bë pranë autoritete të tjera dhe jo në polici.

**FIGURA 6: ARSYET PËR MOSKALLËZIMIN E DHUNËS NË POLICI (BE-27, %)<sup>a,b</sup>**



**Shënime:**

<sup>a</sup> Nga të anketuarit në BE-27, nuk e kallëzuan në polici incidentin më të fundit të dhunës së përjetuar në pesë vitet para anketës (n = 2 317); rezultate të ponderuara.

<sup>b</sup> Në anketë, të anketuarit mundën të jepnin një ose më shumë arsye për moskallëzimin e incidentit, sipas rastit specifik. Të anketuarit mund të përgjigjeshin edhe me "nuk e di" ose "preferoj të mos e them".

Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)



Pjesa më e madhe e incidenteve të dhunës dhe ngacmimit nuk kallëzohen tek autoritetet, ndërsa shumica e krimeve ndaj pronës për të cilat u bënë pyetje në anketë kallëzohen në polici. Gjithashtu, disa incidente që nuk kallëzohen në polici, kallëzohen tek autoritetet e tjera. Shkalla e lartë e kallëzimit të krimit ndaj pronës vjen kryesisht për shkak se kallëzimi është parakusht për të përfituar dëmshpërblimin për incidentin, për shembull nga një shoqëri sigurimesh. Këto rezultate na sugjerojnë se njerëzit janë të gatshëm të kallëzojnë krimin në polici kur e konsiderojnë të efektshëm, pra kur kallëzimi ka rezultate konkrete dhe të dobishme.

Incidentet e dhunës fizike u kallëzuan më shumë në rastet ku incidentet shkaktuan lëndime, pasoja psikologjike dhe ishin me natyrë seksuale.

Krahasimet midis llojeve të krimit, si p.sh. midis krimit të dhunshëm dhe krimit ndaj pronës, duhen bërë me kujdesin më të madh. Megjithatë, rezultatet tregojnë se për disa lloje krimesh, shumë incidente kallëzohen tek autoritete të ndryshme nga policia. Ky fakt mund të nxisë krijimin e mundësive alternative për kallëzimin e një kategorie incidentesh. Anketa e FRA-së për dhunën ndaj grave mbështet përfundimet e paraqitura këtu, pasi tregon se shumë gra, viktimat të dhunës fizike dhe seksuale, kontaktojnë mjekët dhe shërbimet shëndetësore dhe jo policinë. Rezultatet e anketës së FRA-së për përvojat e imigrantëve dhe pasardhësve të tyre, për përvojat e romëve, hebrenjve dhe personave LGBTI tregojnë gjithashtu se mjaft viktimat të ngacmimit dhe dhunës së nxitur nga urrejtja, pas incidentit, kontaktojnë ofrues të ndryshëm shërbimesh, ndërsa nuk e kallëzojnë incidentin në polici.

Viktimat kanë të drejtën për zgjidhje ligjore të efektshme përmes sistemit të drejtësisë penale. Për të vërtetuar pretendimin e tyre, viktimat duhet të kenë qasje në sistemin e drejtësisë penale (neni 47 i Kartës) dhe kjo qasje nuk duhet të jetë vetëm në teori, por qasje e efektshme në praktikë. Kjo kërkon lehtësimin praktik të kallëzimit nga ana e viktimave në polici, duke i fuqizuar dhe inkurajuar ato, në pajtim me objektivin e përgjithshëm të nenit 1 të direktivës “Për të drejtat e viktimave” dhe me deklaminin 63 të tij, i cili bën thirrje për shërbime mbështetëse të besueshme. Këto shërbime duhet të jenë të disponueshme për viktimat, pavarësisht faktit nëse viktimat bënë ose jo kallëzim formal të krimit pranë autoritetit kompetent (neni 8, paragrafi 5). Përveç kësaj, direktiva cilëson se viktimat duhet të trajtohen me respekt, ndjeshmëri, profesionalizëm dhe të mos diskriminohen nga autoritetet kompetente; profesionistët që mund të merren me marrjen e kallëzimeve duhet të trajnohen, çka mund ta bëjë më të lehtë kallëzimin; këtu inkurajohen edhe mekanizmat e kallëzimit nga palë të treta, si dhe përdorimi i teknologjisë së komunikimit për të bërë kallëzimin.

Në strategjinë e BE-së për të drejtat e viktimave (2020–2025) tërhiqet vëmendja se, pavarësisht masave të parashikuara në direktivën “Për të drejtat e viktimave”, në përgjithësi shkalla e ulët e kallëzimit të krimit është problem serioz, sidomos për sa u takon rasteve të dhunës seksuale dhe asaj me bazë gjinore. Strategjia u referohet edhe vlerave të ulëta të kallëzimit të krimit nga ana e komuniteteve të varfra ose të cenueshme ose nga ana e pakicave, komunitete që mund të jenë mosbesuese ndaj autoriteteve publike, gjë që i pengon ato të kallëzojnë krimet. Në këtë kontekst, strategjia për të drejtat e viktimave u kërkon shteteve anëtare “të sigurojnë zbatimin e plotë dhe korrekt të direktivës “Për të drejtat e viktimave” dhe të rregullave të tjera të BE-së për viktimat e krimeve të veçanta, sidomos të dispozitave për qasjen e viktimave tek informacioni, mbështetja dhe mbrojtja”.

# DËSHMIMI I KRIMIT DHE REAGIMI

**Më shumë se një në dy persona ne BE do të ishte i gatshëm të ndërhynte nëse do të ishte dëshmitar i një veprë penale. Por, një në pesë persona nuk do të ishte i gatshëm të ndërhynte.**

## OPINIONI 6 I FRA-SË

Shtetet anëtare të BE-së duhet të konsiderojnë rritjen e përpjekjeve të ndërgjegjësimit për të nxjerrë në pah përgjegjësinë individuale në dëshmimin e një veprë penale, çka do të rriste shkallën e kallëzimit të këtyre veprave tek autoritetet.


Shtetet anëtare inkurajohen të organizojnë fushata për të rritur gatishmërinë e dëshmitarëve për të ndërhyrë në mbrojtje të dinjitetit dhe të drejtave të një personi tjetër kur ky ndodhet në rrezik, duke ruajtur ndërkohë sigurinë e dëshmitarëve.

Për të ndihmuar më tej qasjen e viktimave të drejtësisë, shtetet anëtare mund të konsiderojnë krijimin e mekanizmave të kallëzimit nga palë të treta të veprave penale të cilët do t'i inkurajonin dëshmitarët të cilët nuk kanë dëshirë të hyjnë në marrëdhënie me sistemin e drejtësisë penale (për shembull duke i telefonuar policisë), që të kontaktonin një palë të tretë, si për shembull organizatat e shoqërisë civile. Shtetet anëtare mund të marrin gjithashtu parasysh rritjen e mundësive për mënyra alternative të kallëzimit të krimit nga vetë personi, si për shembull me anë të postës elektronike, regjistrimeve video ose formularëve elektronikë në internet.

- ★ Në rast se do të shihnin dikë të godiste partnerin në rrugë, 54% e personave në BE-27 do të ishin "të gatshëm" ose "shumë të gatshëm" të ndërhynin. Rezultatet janë të ngjashme kur personat u pyetën për mënyrën se si do të reagonin ndaj një prindi që godet me pëllëmbë fëmijën në rrugë, ku 52% ishin "të gatshëm" ose "shumë të gatshëm" për të ndërhyrë".
- ★ Në rast se do të ishin dëshmitarë të një krimi jo të dhunshëm ndaj mjedisit (për shembull, nëse do të shihnin dikë që flak një frigorifer të përdorur në një fshat), 57% do të ishin "të gatshëm" ose "shumë të gatshëm" të ndërhynin.
- ★ Përgjithësisht, njerëzit janë më të prirur të lajmërojnë policinë kur shohin dikë që godet partnerin, ndjekur nga hedhja e frigoriferit të vjetër. Mesatarisht, njerëzit në BE-27 do të ishin më pak të gatshëm të përfshinin policinë nëse do të shihnin një prind duke goditur fëmijën me pëllëmbë.
- ★ Përqindja e personave që "nuk ishin fare të gatshëm" të dëshmonin në gjykatë, edhe nëse do t'u kërkohej, varion nga 17% në rast se do të shihnin dikë duke goditur partnerin deri në 25% në rast se do të shihnin një prind duke goditur fëmijën me pëllëmbë. Megjithatë, këto rezultate ndryshojnë shumë ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, sidomos kur vjen puna te një prind që godet fëmijën.
- ★ Gatishmëria e njerëzve për të hyrë në marrëdhënie me sistemin e drejtësisë penale (si p.sh. duke lajmëruar policinë dhe, nëse do t'u kërkohej, duke dëshmuar në gjykatë) është më e ulët te personat më të moshuar, tek ata me nivel të ulët arsimor dhe te personat me të ardhura të ulëta mujore.
- ★ Në BE-27, njerëzit janë më pak të gatshëm të ndërhyjnë kur një grua godet një burrë (44% janë "të gatshëm" ose "shumë të gatshëm"), sesa kur një burrë godet një grua (64% "të gatshëm" ose "shumë të gatshëm").

Kohezioni social përfshin ndjenjën e bashkëpunimit dhe të solidaritetit të individëve, duke përfshirë këtu gatishmërinë e tyre për të ndërhyrë kur shkelen të drejtat e të tjerëve. Çdo rend normativ mbështetet te gatishmëria e pjesëtarëve të një komuniteti për të mbrojtur normat e veta bazë. Rezultatet e anketës tregojnë se pak më shumë se gjysma e njerëzve në BE do të ishin të gatshëm të ndërhynin aktivisht nëse do të shihnin njerëz të tjerë duke u sulmuar në publik, ndërsa akoma më shumë njerëz do të ishin të gatshëm të ndërhynin nëse do të ishin dëshmitarë të një krimi mjedisor që nuk kryhet kundër një personi.

**FIGURA 7: GATISHMËRIA PËR TË REAGUAR NË RASTIN E DËSHMITIT TË DISA VEPRAVE TË CAKTUARA PENALE, SIPAS SKENARIT DHE LLOJIT TË VEPRIMIT (BE-27, %)**



*Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019; mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)*

Shënime:

Nga të gjithë të anketuarit në BE-27, të cilëve iu kërkua të plotësojnë pjesën e anketës “Ndërgjegjësimi për të drejtat dhe përgjegjësitë” (n = 24 354); rezultate të ponderuara.

Kur krimi ndodh në publik, dëshmitarët e tij mund të luajnë rol kritik duke mbështetur viktimën. Këtu mund të përfshihet, për shembull, ndërhyrja e njerëzve në situatën kur shohin se po ndodh një krim, lajmërimi i policisë ose, nëse nevojitet, dëshmia në gjykatë kundër autorit të krimit. Për disa vepra penale, si për shembull krimin kundër mjedisit, si rast i përdorur në anketë, shpesh nuk ka një “viktimë” të vetme, por ata që kalojnë atypari mund të luajnë rol të rëndësishëm duke njoftuar autoritetet. Për sa u takon llojeve të tjera të veprave penale, për shembull ato që kanë të bëjnë me një grup viktimash tepër të cenueshëm, si fëmijët, roli thelbësor i publikut mund të shihet në kontekstin e nevojës për masa të efektshme për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës (këtu përfshihet përdorimi i forcës fizike që synon të shkaktojë njëfarë dhimbjeje ose paretë, të lehtë gjithsesi, p.sh. të qëlluarit me pëllëmbë), ndërkohë që fëmijët janë nën kujdesin e prindërve dhe të të tjerëve, në pajtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (CRC).

Në deklaminimin numër 63, direktiva “Për të drejtat e viktimave” shkon deri diku drejt pranimit të rëndësisë së mundësisë së kallëzimit të tërthortë: direktiva kërkon ngritjen e një mekanizmi për kallëzimin nga palë të treta, qoftë edhe nga organizata të shoqërisë civile, për të lehtësuar kallëzimin e veprave penale. Në këtë kontekst, direktiva kërkon gjithashtu mundësinë e futjes në përdorim të teknologjisë së komunikimit, si posta elektronike, regjistrimet video ose formularët elektronikë në internet, për kryerjen e kallëzimeve.

# SHQETËSIMI RRETH VIKTIMIZIMIT POTENCIAL DHE SHMANGIA E RREZIKUT

**Gratë, më tepër se burrat, shmangin vendet dhe situatat nisur nga shqetësimi se mund të bëhen pre e ndonjë sulmi ose ngacmimi. Kjo gjë redukton mundësitë e tyre për t'u përfshirë në jetën publike.**

## OPINIONI 7 I FRA-SË

Shtetet anëtare të BE-së duhet të pranojnë se shqetësimi për sigurinë personale ka ndikime negative, veçanërisht te gratë. Ato shpesh ndiejnë nevojën e kufizimit të vendeve që frekuentojnë dhe të veprimtarive që kryejnë, si një formë reagimi ndaj kërcënimit të sulmit fizik dhe seksual dhe ndaj ngacmimit, siç e tregon raporti i anketës së organizuar nga FRA për dhunën kundër grave. Autoritetet që punojnë për parandalimin e krimit mund të bazohen edhe më tej në rezultatet e kësaj ankete për të vënë në jetë masa që sigurojnë barazinë e aksesit në hapësirat publike, si për shembull rrugë për të parandaluar krimin dhe për të reduktuar frikën nga krimi përmes projektimit me në fokus parametrat mjedisorë.

Masat e shteteve anëtare të BE-së për rritjen e ndjesisë së sigurisë te njerëzit duhet të përqendrohen te grupet e popullsisë që kanë shqetësimin më të madh për sigurinë, duke i orientuar këto grupe drejt shmangies së vendeve dhe situatave të perceptuara si potencialisht të pasigurta. Krahask grave, këtu përfshihen personat me nivel të ulët arsimor, të papunët dhe ata me vështirësi financiare.

- ★ Në BE-27, 63% e personave janë shumë të shqetësuar ose disi të shqetësuar se në 12 muajt e ardhshëm dikush mund të keqpërdorë llogarinë e tyre bankare në internet ose kartat e debitit/kreditit. Ndërkohë, 62% shqetësohen se në 12 muajt e ardhshëm mund t'u vidhet telefoni celular, portofoli ose çanta. Përveç kësaj, 54% janë shumë të shqetësuar ose disi të shqetësuar se dikush mund t'u hyjë në shtëpi për të vjedhur ose mund të përpiqet t'u vjedhë diçka. Për më tepër, 47% janë shumë të shqetësuar ose disi të shqetësuar se mund të përjetojnë një sulm terrorist.
- ★ Disa karakteristika socio-demografike shoqërohen me dallime në masën e shqetësimit të personave në fjalë rreth viktimizimit potencial. Shkalla e shqetësimit rreth viktimizimit potencial është më e lartë te gratë, te personat me nivel të ulët arsimor, tek të papunët dhe te personat që mezi arrijnë në fund të muajit me të ardhurat familjare. Edhe personat me kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkak të një problemi shëndetësor ose aftësisë së kufizuar), personat që kanë lindur jashtë BE-së dhe ata që e konsiderojnë veten pjesë të një pakice etnike shfaqin më shumë shqetësim rreth viktimizimit potencial sesa personat pa kufizime në veprimtarinë e përditshme, personat e lindur në vendet ku zhvillohet anketa dhe ata që nuk e konsiderojnë veten pjesë të një pakice etnike.
- ★ Për shkak të frikës se mund të sulmohen ose ngacmohen fizikisht apo seksualisht, gratë angazhohen më shumë se burrat në shmangien aktive të rrezikut në tri situatat e renditura në anketë: shmangia e vendeve ku nuk ka njerëz të tjerë rrotull, shmangia e disa rrugëve ose zonave të caktuara dhe shmangia e situatave ku mund të jenë vetëm me dikë që njohin.
- ★ Raporti i grave dhe burrave që shmangin frekuentimin e vendeve pa njerëz, është përkatësisht 64% dhe 36%. Shmangia e disa situatave dhe vendeve është më e zakonshme tek të rinjtë, por me dallime të mëdha gjinore. Në grupmoshën 16–29 vjeç, 83% e femrave dhe 58% e meshkujve shmangin një ose më shumë prej tri situatave të përmendura në anketë nga frika se mos sulmohen ose ngacmohen.
- ★ Në mënyrë specifike, 41% e grave e shmang, të paktën ndonjëherë, të qëndruarit vetëm me dikë që njohin nga frika se mos sulmohen ose ngacmohen, krahasuar me 25% të burrave.
- ★ Njerëzit që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose ngacmim janë më të prirur të shmangin situatat që ata i perceptojnë si potencialisht të pasigurta. Për shembull, 37% e grave në BE-27 që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose ngacmim kujdesen që të shmangin situatat të cilat sipas tyre mund të përbëjnë rrezik për sulm fizik, sulm seksual ose ngacmim, krahasuar me 21% të grave që nuk kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose ngacmim.


Mundësia e viktimizimit ka ndikim të ndjeshëm në jetën shoqërore, pasi mund të ndikojë te zgjedhjet e njerëzve, si për shembull te vendimet për vendet ose situatat që duhen shmangur. Në disa raste, kërcënimi që përbën krimi mund të përhapet në një grup shumë më të gjerë njerëzish sesa te ata që janë viktimizuar personalisht. Rezultatet tregojnë një dallim midis përvojave të burrave dhe grave, qoftë për sa i përket shqetësimit rreth viktimizimit potencial nga krime të ndryshme ashtu dhe, veçanërisht, për sa u përket sjelljeve që ndërmarrin për të shmangur rrezikun nga shqetësimi për sigurinë e vetjake. Gratë, veçanërisht vajzat e reja, marrin masa të konsiderueshme për shmangien e rrezikut ndaj kërcënimit të ngacmimit seksual dhe dhunës seksuale (në veçanti), nga të cilat janë më të prekurat. Frika për të frekuentuar vende publike kufizon shumë të drejta themelore, veçanërisht të drejtën për liri (neni 6 i Kartës) dhe të drejtën për jetën private (neni 7).

Shmangia e rrezikut mund të jetë një reagim racional ndaj përvojave, si për shembull përvojat e grave me ngacmimin seksual, siç tregohet nga anketa e FRA-së për dhunën ndaj grave. Megjithatë, ky përfundim duhet vënë në kontekstin e aftësisë dhe barazisë në mundësitë për të përdorur mjediset publike. Gjithashtu, vëmendje duhet t'u kushtohet edhe niveleve më të ulëta që shfaqin burrat në shmangien e rrezikut, duke qenë se ata përjetojnë shkallë të lartë të disa krimeve në hapësirat publike.

Shqetësimi rreth viktimizimit potencial është më i lartë te personat me nivel më të ulët arsimor, tek të papunët, tek ata që kanë kufizime në veprimtaritë e përditshme (për shkaqe shëndetësore ose për shkak të aftësisë të kufizuar) ose tek ata të ardhurat familjare të të cilëve janë të pamjaftueshme për të përballuar jetesën. Kjo gjë mund të lidhet me faktorë të ndryshëm, duke përfshirë të jetuarin në zona me kriminalitet të lartë; ndikimin relativ të krimit ndaj pronës tek ata që kanë vështirësi financiare, krahasuar me personat që i kanë mundësitë financiare për të zëvendësuar lehtësisht objektet e vjedhura ose që kanë polica sigurimi gjithëpërfshirëse; të ardhurat e ulëta që kufizojnë mjetet për të qenë i sigurt, pasqyruar kjo për shembull në shkallën e ulët të pronësisë së një automjeti ose në paaftësinë për të marrë taksigjatë orëve të vona të natës.




**FIGURA 8: SHMANGIA E NJË OSE MË SHUMË PREJ TRI SITUATAVE TË RENDITURA NGA FRIKA E NJË SULMI OSE NGACMIMI, NË 12 MUAJT PARA ANKETËS, SIPAS GJINISË DHE MOSHËS (BE-27, %)<sup>a,b</sup>**



Burimi: FRA, Anketa për të Drejtat Themelore 2019, mbledhja e të dhënave në bashkëpunim me CBS (NL), CTIE (LU) dhe Statistics Austria (AT)


Shënime:

- <sup>a</sup> Nga të gjithë të anketuarit në BE-27 (n = 32 537); rezultate të ponderuara.
- <sup>b</sup> Të anketuarve iu bë kjo pyetje: "A keni bërë, në çfarëdo momenti gjatë 12 muajve të kaluar, ndonjë prej këtyre veprimeve nga frika e një sulmi fizik, seksual apo e një ngacmimi? A) Keni shmangur rrugë të caktuara ose frekuentimin e zonave të caktuara, B) Keni shmangur frekuentimin e vendeve ku nuk ka njerëz të tjerë rrotull, për shembull të parqeve ose parkimeve të makinave. C) Keni shmangur qëndrimin vetëm me dikë që e njihni, i cili ju bën të ndiheni i pasigurt". Figura përmbledh përgjigjet e të anketuarve për të tri alternativat. Në rast se një i anketuar është përgjigjur "shpesh" ose "gjatë gjithë kohës" për njërin prej tri alternativave, përgjigjja është përfaqësuar në atë kategori. Në rast se një i anketuar i është përgjigjur njëres prej tri alternativave me "ndonjëherë", por asnjëres me "shpesh" ose "gjatë gjithë kohës", përgjigjja përfaqësohet më lart me "ndonjëherë". Të anketuarit që u janë përgjigjur të tri alternativave me "nuk e di" ose "preferoj të mos shprehem" janë përfshirë në kategorinë "nuk e di ose preferoj të mos shprehem".



Kjo përmbledhje paraqet përfundimet kryesore të raportit të dytë të FRA-së mbi Anketën për të Drejtat Themelore.

FRA ka nxjerrë disa botime të tjera që paraqesin rezultate të përzgjedhura nga anketa. Këto mund të gjenden në faqen e internetit të FRA-së.





# PËRKRAHJA DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TUAJA THEMELORE NË BASHKIMIN EVROPIAN —

Kjo përmbledhje paraqet idetë kyçe të raportit të dytë kryesor të FRA-së, mbështetur në Anketën për të Drejtat Themelore. Anketa mbledhi të dhëna nga rreth 35 000 njerëz lidhur me përvojat, perceptimet dhe opinionet e tyre mbi një sërë çështjesh që përmbledhen në mënyra të ndryshme nga të drejtat e njeriut.

Raporti i dytë i FRA-së përqendrohet te përvojat e personave si viktimë të disa llojeve të përzgjedhura krimesh ku përfshihen dhuna, ngacmimi dhe krimi ndaj pronës. Raporti merr gjithashtu në shqyrtim edhe shpeshësinë e kallëzimit të këtyre krimeve në polici; shkallën e shqetësimit rreth viktimizimit potencial; dhe nivelin e gatishmërisë për të ndërhyrë, për të kallëzuar në polici ose, nëse do t'u kërkohej, për të dëshmuar në gjykatë në situata të caktuara.

Rezultatet e paraqitura ofrojnë të dhëna e para të një ankete mbi krimin në të gjithë BE-në për përvojat e viktimizimit të popullsisë së gjerë. Këto rezultate mund të përdoren për të orientuar politikën dhe legjislacionin kombëtar dhe ato të BE-së për viktimat e krimit.



Victims



Access to justice



Information society



EU Charter of Fundamental Rights

FRA – AGJENCIA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE

Schwarzenbergplatz 11 - 1040 Vjenë - Austri

T +43 158030-0 - F +43 158030-699

[fra.europa.eu](http://fra.europa.eu)



[facebook.com/fundamentalrights](https://facebook.com/fundamentalrights)



[twitter.com/EURightsAgency](https://twitter.com/EURightsAgency)



[linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency](https://linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency)



Publications Office  
of the European Union